

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR

LËNDA: HISTORI

**“NJOHURI THEMELORE PËR HISTORINË MODERNE
BOTËRORE”
(SHEK. XVI – FUNDI I SHEK. XIX).**

(klasa e shtatë)

TIRANË, 2005

I. H Y R J E

Programi "Njohuri themelore për historinë moderne botërore" për klasën e VII të shkollës 9-vjeçare përfshin studimin e zhvillimeve më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore që nga Rilindja e vonë Evropiane deri në fund të shekullit XIX.

Në ndryshim nga ai paraardhës, programi i ri pasqyron ndryshime të rëndësishme si në strukturë, ashtu edhe në përmbajtje.

Nga pikëpamja strukturore janë pasqyruar në mënyrë të sintetizuar njohuritë, shprehitë dhe vlerat edukative, të cilat përbëjnë objektivat kryesorë të lëndës që duhet të përvetësojnë nxënësit në fund të vitit shkollor, të cilat e ndihmojnë mësuesin për një vlersim sa më objektiv të arritjeve.

Përveç shtimit të numrit të orëve të përsëritjes dhe në dispozicion të mësuesit, janë parashikuar edhe orë të veçanta për zhvillimin e testeve.

Nga pikëpamja e përmbajtjes, mbi bazën e përvojës më të mirë të vendeve evropiane dhe të arritjeve më të reja shkencore, për periudhën në fjalë janë bërë rikoncepime për tema dhe periudha të tëra historike, të cilat do të ndikojnë në një formim më të plotë historik të nxënësve.

II OBJEKTI I STUDIMIT

Objekti i studimit të lëndës "Njohuri themelore për historinë moderne botërore" është zhvillimi historik i shoqërisë njerëzore dhe i mendimit shoqëror, duke filluar nga Rilindja e vonë Evropiane deri në fund të shekullit XIX në përmasat civile, ekonomike, shoqërore, politike dhe fetare.

III OBJEKTIVAT KRYESORË TË PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Në përfundim të klasës VII nxënësit duhet:

A. K R O N O L O G J I

1. Të jenë të aftë të rendisin ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet historike të studiuara sipas rendit kronologjik, duke krijuar për këtë qëllim linjën e kohës.

2. Të jenë të aftë të përdorin me saktësi fjalë apo fraza që karakterizojnë periudha të ndryshme historike brenda kufijve të përfshirë në program, si: protestanizëm, reformacion katolik, revolucion industrial, iluminizëm, revolucion borgjez, nacionalizëm etj.

B. G J E R Ë S I A D H E T H E L L Ë S I A E N J O H U R I V E H I S T O R I K E

1. Të njohin përmbajtjen e koncepteve të reja historike, si: reformacioni katolik, iluminizëm, nacionalizmi etj., të zotërojnë fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e lëndës dhe të aftësohen ta përdorin atë.

2. Të dinë të analizojnë tiparet karakteristike të periudhave dhe të shoqërive njerëzore të studiuara, duke nxjerrë në pah veçoritë e tyre dhe duke demonstruar në këtë mënyrë se i kanë kuptuar këto karakteristika.

3. Të dinë të përshkruajnë, të analizojnë dhe të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, të situatave dhe ndryshimeve të ndodhura në vendet e përfshira në studim.

4. Të jenë të aftë për të vlerësuar ndryshimet e rëndësishme që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të shoqërisë njerëzore në periudhën e përfshirë në studim, si dhe rolin e figurave të ndryshme historike në këtë drejtim.

5. Të njohin disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë të periudhës së përfshirë në studim.

C. INTERPRETIMI

1. Të jenë të hapur ndaj pikëpamjeve të ndryshme të shfaqura ndaj zhvillimeve historike të periudhave të caktuara dhe të kuptojnë se për ngjarje, dukuri, situata e figura të ndryshme historike ka më shumë se një interpretim.

2. Të dinë të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike.

3. Të jenë në gjendje të interpretojnë tabllo, foto, harta historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike të përfshira në studim.

4. Të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e veta, duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet apo dukuritë historike të studiuara.

Ç. KËRKIME HISTORIKE

1. Të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhave historike të studiuara, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tabllo, harta historike etj.

2. Të jenë të aftë për të bërë pyetje në shërbim të grumbullimit të informacionit të duhur për çeshtje të ndryshme të përfshira në studim.

3. Të jenë të aftë për të zbuluar informacione të rëndësishme nga burime të ndryshme historike (harta, materiale të shkruara, ilustrime të ndryshme etj.).

D. ORGANIZIMI DHE KOMUNIKIMI

1. Të jenë në gjendje të përzgjedhin dhe të rendisin në mënyrë logjike të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme historike për vendet dhe periudhat e studiuara.

2. Të dinë të komunikojnë njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e periudhave historike të studiuara duke përdorur për këtë qëllim teknika të ndryshme, si: përshkrimin, shpjegimin etj.

3. Të marrin pjesë në debate, në të cilat, nëpërmjet njohurive dhe aftësive të fituara, të japin ndihmesë në arritjen e kompromiseve për probleme të caktuara.

IV. METODAT E TE MESUARIT

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje me veçoritë e temave mësimore, bazën didaktike, nivelin e formimit historik të nxënësve etj. Gjatë orës mësimore mund të përdoren disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njera tjetrën në mënyrë që në fund të saj të jenë arritur të gjitha objektivat e parashikuara nga programi mësimor.

Metoda e teknika të tilla mund të jenë shpjegimi, të mësuarit problemor etj. Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave të ndryshme mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e bazës materiale përkatëse e cila garanton arritjen e rezultateve të larta.

V. METODOLOGJIA E VLERESIMIT

Vlerësimi i nxënësve të jetë sistematik dhe i larmishëm. Ai të bëhet për njohuritë më të rëndësishme, duke shmangur detajet e panevojshme.

Vlerësimi i nxënësve qoftë ky sistematik (për çdo temë mësimore), periodik (për çdo kapitull), semestral apo vjetor mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: me shkrim, me gojë (pjesërisht apo ballor), veprimtarisë praktike, testimi etj. Gjatë realizimit të këtij të fundit të mbahen parasysh disa nga cilësitë më kryesore të tij, si: vlefshmëria, besueshmëria, objektiviteti dhe përdorshmëria. Në rastet e zbatimit të testeve, të mbahen parasysh :

1. Nxënësit të jenë familjarizuar që më parë me këtë teknikë vlerësimi.
2. Testi të përfshijë cilësitë më kryesore, ndërsa shkalla e vështirësisë të jetë në përshtatje me nivelin e përvetësimit të njohurive historike nga nxënësit.
3. Të hartohet nga vetë mësuesi një sistem i thjeshtëzuar pikëzimi.

Përveçse në regjistrin e klasës, njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit, plotësohet më tej edhe nga shënimet e veta të mësuesit.

PROGRAMI SINTETIK

35 javë x 2 orë	70 orë
Njohuri të reja	57 orë
Përsëritje dhe orë në dispozicion	10 orë
Teste	3 orë
Gjithsej	70 orë

PROGRAMI ANALITIK

K R E U I

SHOQËRIA EVROPIANE NË FILLIMET E KOHËS MODERNE (7 orë)

1. Rilindja e vonë evropiane
2. Reforma protestante dhe fundi i unitetit fetar në Evropë
3. Përhapja e protestanizmit
4. Reformacioni katolik
5. Zbulimet e mëdha gjeografike
6. Pasojat e zbulimeve të reja gjeografike
7. Anglia bëhet një fuqi e madhe detare.

K R E U II

KONSOLIDIMI I MONARKIVE ABSOLUTE EVROPIANE, NJË EPOKË KONFLIKTESH 1500-1789 (7 orë)

1. Monarkia spanjolle. Fundi i ëndrrës perandorake
2. Luftërat fetare
3. Franca gjatë sundimit të Luigjit XIV
4. Anglia, një fuqi tregtare dhe monarki kushtetuese
5. Prusia, një fuqi e re në skenën evropiane
6. Rusia , perandori e fuqishme
7. Zhvillimi i artit dhe kulturës gjatë shekullit XVII

K R E U III

NDRYSHIMET NË JETËN EKONOMIKE E SHOQËRORE NË SHEKUJT XVII - XVIII (2 orë)

1. Revolucioni i parë industrial
2. Një shoqëri e re, një zhvillim i pandalshëm

K R E U IV

IDETË E REJA DHE KOMBET E REJA (8 orë)

1. Iluminizmi
2. Krijimi i ShBA
3. Franca në prag të revolucionit
4. Revolucioni francez. Përmbysja e regjimit absolut.
5. Napoleon Bonaparti
6. Fundi i Perandorisë së Napoleonit
7. Pavarësia e Amerikës Latine
8. Kombet e reja të Amerikës Latine

K R E U V

EVROPA NË VITET 1815-1850 (5 orë)

1. Kongresi i Vjenës. Epoka e restaurimit
2. Zhvillimi ekonomik
3. Zhvillimet kulturore e shkencore
4. Revolucionet borgjeze të viteve 1830 në Evropë
5. Revolucionet e vitit 1848

K R E U VI

NACIONALIZMI DHE REALIZMI 1850-1871 (5 orë)

1. Epoka e nacionalizmit dhe realizmit
2. Bashkimi i Gjermanisë
3. Bashkimi i Italisë
4. Problemet kombëtare dhe ndryshimet në Perandorinë Austriake
5. Zhvillimi i ShBA. Lufta Civile

K R E U VII

PERANDORIA OSMANE DHE BALLKANI NË SHEK. XVI-XIX (8 orë)

1. Fundi i zgjerimit të Perandorisë Osmane
2. Lëvizjet përparimtare në Perandorinë Osmane
3. Formimi dhe konsolidimi i shtetit modern grek.
4. Formimi dhe forcimi i shtetit serb
5. Shteti i pavarur bullgar
6. Krijimi i shtetit të pavarur rumun.
7. Përpjekjet për krijimin e shtetit autonom shqiptar

8. Vendet e tjera të Ballkanit

K R E U VIII

FILLIMET E QEVERISJES SË DEMOKRACISË LIBERALE 1871-1900 (8 orë)

1. Revolucioni i dytë industrial
2. Rritja e qyteteve dhe problemet sociale
3. Zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike dhe politike. Tregu botëror.
4. Zhvillimet politike në Britaninë e Madhe
5. Zhvillimet politike në Francë. Republika III
6. Gjermania
7. Demokratizimi i mëtejshëm i ShBA
8. Perandoria Ruse

K R E U IX

VENDET AZIATIKE DHE AFRIKANE NË KOHËT MODERNE (5 orë)

1. India në kohët moderne. Vendosija e sundimit britanik në Indi
2. Kina
3. Tiparet e zhvillimit të Japonisë.
4. Shtrirja e sundimit të fuqive evropiane në Azi
5. Pushtimet koloniale në Afrikë

K R E U X

QYTETËRIMI NË PRAGUN E SHEKULLIT XIX (2 orë)

1. Arritjet në qytetërimin perëndimor. Lindja e mendimeve të reja.
2. Imperializmi dhe nacionalizmi i skajshëm kërcënojnë stabilitetin.

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT NË LËNDËN HISTORI PËR KLASËN E SHTATË TË CIKLIT TË MESEM TË ULËT

Përveç kërkesave që parashtrihen në këtë programin të lëndës së historisë për klasën e shtatë të shkollës 9-vjeçare, puna e institucioneve dhe e grupeve të autorëve që do të marrin përsipër hartimin e teksteve, të përqendrohet edhe në plotësimin e disa kritereve të tjera që kanë të bëjnë me këndvështrime të përgjithshme dhe më specifike shkencore apo didaktike, të cilat do të paraqiten në vijim.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë instrumenti më efektiv i procesit mësimor. Për këtë arsye, tekstet e nxënësit të paraqesin veçori si në trajtimet konceptuale, ashtu edhe në formën e paraqitjes.

Hartimi i teksteve është proces. Ai duhet:

- ◆ Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe në veçanti me programin e reformuar dhe standardet lëndore;
- ◆ Të marrë parasysh përvojën e deritanishme të shkollës sonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera;
- ◆ Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore, duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të nxënësve dhe mësuesve në këtë nivel;
- ◆ Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës;
- ◆ Të synojë nxitjen e ideve të reja në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit në lëndën e historisë;
- ◆ Të synojë realizimin e një dokumenti fleksibël, që i lë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, edhe nga ana metodike.

II. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË LËNDËS SË HISTORISË

Teksti i lëndës së historisë, synon ndër të tjera, të krijojë në klasë, në miniaturë, një mjedis historik, të cilin nxënësit duhet ta përjetojnë. Ai të krijojë mundësinë jo vetëm të bashkëpunimit krijues të nxënësve me njëri-tjetrin, por edhe të bashkëpunimit ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, madje më gjerë bashkëpunimin e mjedisit shkollor me mjedisin jashtë shkollës.

Teksti i lëndës së historisë të jetë *në përputhje me programin konkret të miratuar nga MASH*. Ai të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjike që përmbahen në të. Në këtë mënyrë teksti t'u përmbahet qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe të programit, në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysh të qëllimeve në dy nivele:

1. *të qëllimeve të shprehura hapur* në program. Pra në tekst të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari që synojnë të arrihet qëllimi i shprehur në program;
2. *qëllimeve të nënkuptuara*. Kjo do të thotë që autorët e teksteve të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, duhet të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla, të cilat në shumë raste janë edhe themelore.

Teksti nuk është përkthim i programit, i cili ka karakter sa detyrues, aq edhe rekomandues dhe autorët duhet ta mbajnë parasysh atë. Këta të fundit, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe duke patur perceptimin e tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor progresi në mësimdhënien e lëndës së historisë. Në këtë drejtim, autorët mund të shfrytëzojnë:

- ◆ Hapësirat dhe fleksibilitetin e programit (orët në dispozicion ose përsëritjet);

- ◆ Aparatin pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo gjë tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.

Teksti të japë mundësi të sjillen në klasë shembuj konkretë nga periudha historike e përfshirë në studim.

Nga pikëpamja pedagogjike, teksti të mundësojë realizimin e objektivave në *fishën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve*.

Kjo do të thotë që teksti duhet të ofrojë si për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit, *krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm*. Këtu duhet të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga njohuritë historike. Për këtë arsye, autori (autorët) i tekstit të parashikojë ato njohuri që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

Sistemi i pyetjeve në fund të njësive mësimore (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera), duhet të ofrojë mundësinë që nxënësit:

- Në mënyrë të pavarur të përvetësojë informacionin e tekstit;
 - Të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësive mësimore dhe të objektivave të programit;
 - Të krijojë mendimin dhe qëndrimet e tij të pavarura, të mbështetura me argumente, por të pranojë, të respektojë dhe të marrë parasysht argumentet e të tjerëve;
- Mësuesit :
- Të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së historisë;
 - Të planifikojnë më mirë orën mësimore;
 - Të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
 - T'i mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
 - T'i mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuara gjatë procesit mësimor që janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe të shprehive të reja;
 - Të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj.

- ◆ Teksti të përmbajë mësimet ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qartë mësimore, në përputhje me programin ose me standardet lëndore.
- ◆ Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shtesë nga burime të tjera informacioni (atlasë, harta, foto, fletore pune, albume historike etj.), gjë që do ta bënte tekstin ose njësinë mësimore më fleksibël dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur e kërkimore të nxënësve.
- ◆ Gjuha e teksteve të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.
- ◆ Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësive mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.
- ◆ Nga pikëpamja sasiore, autorët e tekstit të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpeshherë krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të

dallojnë *informacionin kryesor* nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësisë mësimore.

- ◆ Autorët të bëjnë kujdes që të mos krijojnë mbingarkesë edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit në kushtet e kufizimit sasior (informacionit) dhe kohor të njësisë mësimore. Informacionet shtesë (ilustrimet, fotot, tekstet, grafikët etj.) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.
- ◆ Njësia mësimore e tekstit të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e funksioneve të tekstit, si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtësore të temave të veçanta.
- ◆ Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (p.sh., temës) të jenë të njësuara gjatë gjithë tekstit.
- ◆ Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (tituj, tekste, figura, pyetësorë, detyra, ushtrime ritmike dhe melodike etj.) të jetë tërheqëse dhe e mbështetur në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe temës, në veçanti.
- ◆ Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, qartësimeve, ngjyrave etj., të jetë i menduar mirë dhe në shërbim të çështjes që trajtohet.

Teksti të jetë me katër ngjyra.

Teksti të ketë 150 faqe A4

Formati të jetë 260 x 200 mm.